

JETËSHKRIM

Sokol Geg STOJANI

1. TË DHËNAT PERSONALE

Nr. Personal i Kartës së Identitetit: [REDAKTUAR]

Shtetësia : **Shqiptare**

Datëlindja: **31.05.1971**

Vendlindja: **Tiranë**

Adresa: Nj.A. nr. 5, Rr. "Zef Jubani", [REDAKTUAR] Tiranë.

Tel/Cel: **+355** [REDAKTUAR]

Adresa Elektronike : sokol.stojani@pp.gov.al

2. TË DHËNA PËR PËRVOJËN PROFESIONALE

(Renditen të gjitha, në zbritje kohore, duke filluar nga veprimtaria aktuale profesionale)

Periudha : 19 Shtator 2018, e në vijim

Lloji i detyrës/funksionit/veprimtarisë :

Prokuror në Drejtorinë Gjyqësore

Përmbledhje e përgjegjësiave të ushtruara :

Detyrat funksionale në këtë drejtori pas hyrjes në fuqi të paketës së ligjeve në kuadër të reformës në drejtësi, kanë të bëjnë me:

- Përfaqësimin e Prokurorisë së Përgjithshme për çështje penale të cilat shqyrtohen në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese;
- Ndjekja e praktikave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes prokurorive të ndryshme për kompetencën lëndore apo tokësore;
- Kontrollonjë ligjshmërinë dhe efektivitetin, në përfaqësimin e akuzës në gjykim.
- Nxjerrje problematikash që evidentohen nga çështjet e ndjekura, me synim informimin e Prokurorit të Përgjithshëm për nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme;
- Çdo vit, pas analizës së treguesve të gjëndjes, përhapjes, tendencave të kriminalitetit etj, i jep mendim Prokurorit të Përgjithshëm për nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme.

Ky Jetëshkrim i shërben për përdorim Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për procedurat e verifikimit dhe vlerësim, pikëzimit, renditjes së kandidaturës.

- Analizon treguesit kryesorë nga statistikat e ekzekutimit të vendimeve penale në shkallë vendi, për të konkluduar mbi efektivitetin e punës të prokurorisë si dhe të organeve të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve penale;
- Dhënia e ndihmës metodike kur kërkohet nga prokuroritë e shkallëve më të ulta;
- Pjesëmarrja në grupe pune apo takime të ndryshme ndërinstytucionale të ngarkuara nga Prokurori i Përgjithshëm;
- Ndjekja e praktikave të ndryshme të iniciuara nga institucione shtetërore, publike, shtetas etj, për probleme që lidhen me ekzekutimin e vendimeve penale etj;
- verifikojnë probleme të ngritura nga Avokati i Popullit lidhur me shkeljen e të drejtave të të dënuarve;
- si dhe detyra të tjera që i ngarkuara me ligj Prokurorit të Përgjithshëm, për të cilat ky i fundit autorizon prokurorët e kësaj drejtorie;

Periudha : 23 Janar 2018 deri 19 Shtator 2018;

Lloji i detyrës/funksionit/veprimtarisë :

Drejtor i Drejtorisë së Ndihmës për Subjektet e Posaçme, Mbrojtjes së Dëshmitarëve, Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore, Studimeve, Projekteve

Përmbledhje e përgjegjësive të ushtruara :

Detyrat funksionale në këtë drejtori pas hyrjes në fuqi të paketës së ligjeve në kuadër të reformës në drejtësi, kanë qenë komplekse dhe konsistonin në:

- Organizimi i punës dhe koordinimi me strukturat e tjera si brenda prokurorisë ashtu edhe me institucionet e tjera, brenda sferës së veprimtarisë së saj (*për të inicuar verifikime, hetime disiplinore, organizimin e takimeve, trajnimeve, përgatitjen e projektakteve normative, studimeve, analizave, etj*);
- Monitorimi për zbatimin e urdhrave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm ku për problematikat e hasura dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre i raportohet këtij të fundit;
- Përfaqësimi i Prokurorisë në diskutimet për politikën e institucionit apo në nivel ekspertësh në takime të ndryshme, pas miratimit nga Prokurori i Përgjithshëm;
- Trajtimin e ankesave, kërkesave apo infove në lidhje me veprimtarinë e drejtorisë;
- Paraqita e propozimeve lidhur me personelin e sektorëve, buxhetin e prokurorisë, për atë pjesë që ndikon në veprimtarinë e sektorëve, legjislacionin për të drejtat e viktimave dhe dëshmitarëve;
- Merr masat për të respektuar konfidencialitetin e të dhënave për të cilat vihet në dijeni në përputhje me ligjin procedural penal dhe kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale;

Ky Jetëshkrim i shërben për përdorim Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për procedurat e verifikimit dhe vlerësim, pikëzimit, renditjes së kandidaturës.

- Drafton aktet normative të Prokurorit të Përgjithshëm ose të përbashkëta me institucione të tjera, si: rregullore, urdhra, udhëzime, memorandume/marrëveshje;
- Organizonte punën për studimin e projektakteve ligjore e nënligjore, që vijnë për mendim në Prokurorinë e Përgjithshme, nga Ministria e Drejtësisë e institucionet e tjera, duke parashtruar sugjerime për ndryshime, plotësime apo redaktime dhe/ose duke bërë vërejtjet përkatëse;
- Përgatit projekt-raporte, projekt-informacione periodike dhe/ose mendime për çështje të kërkuara, përfshirë ato lidhur me përmbushjen e angazhimeve në kuadrin e procesit të integritit europian;
- Ndjek në dinamikë praktikën gjyqësore penale të vendimeve unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në fushën penale;
- koordinon dhe bashkëpunon me strukturat e prokurorisë për çështjet e integritit në BE;
- Përgatit informime periodike për progresin e prokurorisë në përmbushjen e angazhimeve në kuadrin e procesit të integritit europian;
- Ndjek projektet e ndryshme për prokurorinë dhe merr kontakte me partnerët ndërkombëtarë apo shqiptarë për të siguruar projekte të tjera në dobi të institucionit.
- Identifikon nevojat për trajnime të prokurorëve dhe stafeve mbështetës nëpërmjet marrjes së kontakteve me ta dhe në bashkëpunim me donatorët, organizon trajnimet jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës.
- Inspektimin e prokurorëve në rastet që vlerësohet se duhet të kryeheshin verifikime të plota të shqetësimeve të ngritura apo dhe kur duhet kryer hetim disiplinor;
- Ndjekjen e gjithë veprimtarisë së prokurorisë që lidhet me menaxhimin e burimeve njerëzore (të prokurorëve, nëpunësve civil etj), në varësi të situatës së krijuar nga vetingu etj, për të informuar më tej Prokurorin e Përgjithshëm, që e kishte këtë kompetencë gjatë periudhës tranzitore deri në krijimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i cili u konsistua në dhjetor 2018;
- Në kuadër të ndihmës për subjektet e veçanta, ishte drejtimi dhe koordinimi i strukturave vartëse në përmbushjen e standardeve të të drejtave të njeriut në drejtësinë për të miturit, qoftë si persona në konflikt me ligjin, si dëshmitarë apo dhe si viktime.
- Qënia si autoritet përgjegjës në mardhëniet me ILDKPKI-në si dhe me për abatimin e ligjit për informimin publik apo mbrojtjen e të dhënave personale.
- Merr pjesë në takime e konferenca i autorizuar nga Prokurori i Përgjithshëm.
- si dhe kryeja funksione dhe detyra të tjera të caktuara me ligj ose me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm.

Ky Jetëshkrim i shërben për përdorim Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për procedurat e verifikimit dhe vlerësim, pikëzimit, renditjes së kandidaturës.

Periudha : 05 Prill 2015 deri 23 Janar 2018;

Lloji i detyrës/funksionit/veprimtarisë :

Prokuror në Drejtorinë Gjyqësore dhe Mbikqyrjes së Ekzekutimit të Vendimeve Penale

Përmbledhje e përgjegjësive të ushtruara :

Detyrat funksionale në këtë drejtori konsistojnë në:

- Përfaqësimin e Prokurorisë së Përgjithshme për çështje penale të cilat shqyrtohen në Kolegjin Penal ose Kolegjet e Bashkuara në Gjykatën e Lartë si dhe në Gjykatën Kushtetuese;
- Përfaqësimin e akuzës në gjyq për vepra penale me juridiksion fillestar në Gjykatën e Lartë .
- Ndjekja e praktikave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes prokurorive të ndryshme për kompetencën lëndore apo tokësore;
- Kontrollon ligshmërinë dhe efektivitetin, në ngritjen dhe përfaqësimin e akuzës në gjykim, nga prokurorët e Prokurorisë së shkakës së parë dhe Prokurorisë së apeleve:
 - a) në shqyrtimin e çështjeve të rekursuara në Gjykatën e Lartë;
 - b) në shqyrtimin e materialeve/praktikave të ardhura në Drejtorinë Gjyqësore dhe Mbikqyrjes së Ekzekutimit të Vendimeve Penale, për ushtrimin me efektivitet të së drejtës së ankimit, në zbatim të akteve normative të Prokurorisë së Përgjithshme;
 - c) në inspektimet e përgjithshme, të pjesëshme ose për çështje të veçanta, që mund të marrin pjesë me urdhër të Prokurorisë së Përgjithshme, duke bashkërenduar me Drejtorinë e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore dhe struktura të tjera;
- Nxjerrje problematikash që evidentohen nga praktikat apo çështjet e ndjekura, me synim informimin e Prokurorisë së Përgjithshme dhe po të dilte e nevojshme nxjerrjen e urdhërave ose udhëzimeve;
- Shqyrtojnë ankesat e ardhura lidhur me çështjet në gjykim ose të gjykuara, duke vendosur për zgjidhjen e duhur ligjore ;
- Bashkërendojnë me Drejtorinë e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore, për të iniciuar trajnime në ato drejtime që evidentohen paqartësi në zbatimin e ligjit material penal dhe/ose ligjit procedural penal, me synim rritjen e nivelit profesional të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, për të rritur kapacitetin në ngritjen dhe përfaqësimin e akuzës në gjykim;
- Çdo vit, pas analizës së treguesve të gjëndjes, përhapjes, tendencave të kriminalitetit etj, japin mendim Prokurorisë së Përgjithshme për nxjerrjen e urdhërave/udhëzimeve.

Ky Jetëshkrim i shërben për përdorim Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për procedurat e verifikimit dhe vlerësim, pikëzimit, renditjes së kandidaturës.

- Analizojnë treguesit kryesorë nga statistikat e ekzekutimit të vendimeve penale në shkallë vendi, për të konkluduar mbi efektivitetin e punës të prokurorisë si dhe të organeve të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve penale;
- Inspektimet e përgjithshme, të pjesëshme ose për çështje të veçanta, që mund të marrin pjesë me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm, duke bashkërenduar me Drejtorinë e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore dhe struktura të tjera;
- Urdhëron dhe mbikqyr ekzekutimin e vendimeve penale ndaj subjekteve që që procedohen me juridiksion fillestar nga Prokuroria e Përgjithshme, si dhe urdhërojnë ekzekutimin e vendimeve me ekzekutim të menjëhershëm të Gjykatës së Lartë dhe të masave të sigurimit të urdhëruara prej saj;
- Shfuqizon urdhër ekzekutimet e kundraligjshëm, të Prokurorëve të ekzekutimit të vendimeve penale të shkallëve më të ulta;
- Kryejnë funksione drejtimi, ndihme metodike dhe kontrolli në ekzekutimin e vendimeve penale në shkallë vendi, si dhe ngarkohet me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore me ekzekutim të menjëhershëm të urdhëruar nga Gjykata e Lartë.
- Verifikon dhe u jep zgjidhje ankesave, kërkesave e informacioneve që të dënuar, familjarë të tyre, shtetas të ndryshëm dhe avokatë i drejtojnë Prokurorit të Përgjithshëm, duke ndërhyrë pranë organeve përkatëse për shkeljet e konstatuara gjatë procesit të ekzekutimit të vendimeve penale;
- Pjesëmarrja në grupe pune apo takime të ndryshme ndër-institucionale të ngarkuara nga Prokurori i Përgjithshëm;
- Verifikojnë probleme të ngritura nga Avokati i Popullit lidhur me shkeljen e të drejtave të të dënuarve;
- si dhe detyra të tjera që i ngarkuara me ligj Prokurorit të Përgjithshëm, për të cilat ky i fundit autorizon prokurorët e kësaj drejtorie;

Periudha : 15 janar deri 05 Prill 2015;

Lloji i detyrës/funksionit/veprimtarisë :

Drejtor i komanduar i Drejtorisë Gjyqësore dhe Mbikqyrjes së Ekzekutimit të Vendimeve Penale

Përmbledhje e përgjegjësive të ushtruara :

Detyrat funksionale në cilësinë e drejtuesit në thelb ishte organizimi i punës së prokurorëve dhe stafit mbështetës, për të garantuar mbarëvajtjen e saj brenda objektit të veprimtarisë së drejtorisë gjyqësore, ku detyrat kryesore janë prezantuar më lart.

Ky Jetëshkrim i shërben për përdorim Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për procedurat e verifikimit dhe vlerësim, pikëzimit, renditjes së kandidaturës.

Periudha : 17 dhjetor 2012 deri 15 janar 2015;

Lloji i detyrës/funksionit/veprimtarisë :

Prokuror në Drejtorinë Gjyqësore dhe Mbikqyrjes së Ekzekutimit të Vendimeve Penale

Përmbledhje e përgjegjësive të ushtruara :

Detyrat funksionale në këtë drejtori janë të përshkruara më lart;

Periudha : 17 Janar 2009 deri 17 dhjetor 2012;

Lloji i detyrës/funksionit/veprimtarisë :

Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit të Hetimit dhe Ndjekjes Penale

Përmbledhje e përgjegjësive të ushtruara :

Detyrat funksionale me cilësinë e drejtuesit konsistojnë në:

- Organizimin dhe drejtimin e aktivitetit të drejtorisë në funksion të përmbushjes së detyrimeve si dhe të detyrave të tjera të ngarkura nga Prokurori i Përgjithshëm;
- Bashkëpunon në mënyrë sa më efektive me zyrat e prokurorisë së niveleve më të ulëta, në përmbushjen sa më të mirë të misionit të prokurorisë dhe detyrave të saj;
- Mbi bazën e informimit të prokurorëve për praktika të ndryshme, përgjithëson problematikën për një periudhë kohe, e cila do të jetë objekt i shqyrtimit dhe zgjidhjes prej saj, apo strukturave të tjera të prokurorisë;
- I propozon Prokurorit të Përgjithshëm strategji periodike për politikën e ndjekjes penale gjatë fazës së hetimit, si pjesë e strategjisë që Prokurori i Përgjithshëm ndërton për ndjekjen penale në përgjithësi.
- Organizon takime të prokurorëve të drejtorisë, kur është e nevojshme të diskutohen probleme të rëndësishme në lidhje me qëndrime sa më të drejta dhe të unifikuara në raport me probleme të caktuara.
- Kontrollon çështjet në hetim apo ato të përfunduara në këtë fazë në të gjitha prokuroritë më të ulëta për çështje të rënda, sensitive apo që janë prioritet i prokurorisë, por jo vetëm dhe, sipas rastit shfuqizon, ndryshon apo miraton vendimet e prokurorëve më të ulët.
- Kontrollonte apo ndiqte drejtpërdrejtë edhe rastet e hetimeve me juridiksion fillestar të Prokurorisë së Përgjithshme kur procedohej ndaj deputetëve, ministrave, Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë etj;

Ky Jetëshkrim i shërben për përdorim Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për procedurat e verifikimit dhe vlerësimit, pikëzimit, renditjes së kandidaturës.

- Ndjekja e praktikave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes prokurorive të ndryshme për kompetencën lëndore apo tokësore;
- Gjatë studimit të procedimeve, përveç zgjidhjes së problematikës së kërkuar, bën një vlerësim të përgjithshëm të tij;
- Evidenton shkeljet gjatë trajtimit të praktikave dhe informon Prokurorin e Përgjithshëm dhe Drejtorinë e Inspektimit;
- Propozon akte normative për Prokurorin e Përgjithshëm, për rregullimin e aspekteve të caktuara të veprimtarisë në të gjithë sistemin e prokurorisë;
- Propozon tek Prokurori i Përgjithshëm ndryshime në ligj që kanë lidhje me misionin e prokurorisë.
- Përfaqëson Prokurorinë në të gjitha takimet, tryezat e rrumbullakta, konferencat, grupet ndërinstucionale, bordet drejtuese etj, të deleguara si kompetenca nga Prokurori i Përgjithshëm.
- si dhe detyra të tjera që i ngarkuara me ligj Prokurorit të Përgjithshëm, për të cilat ky i fundit autorizon prokurorët e kësaj drejtorie;

Periudha : 09 Maj 2008 deri 17 Janar 2009;

Lloji i detyrës/funksionit/veprimtarisë :

Prokuror në Drejtorinë së Kontrollit të Hetimit dhe Ndjekjes Penale

Përmbledhje e përgjegjësisë të ushtruar :

Detyrat funksionale në këtë drejtori janë të përshkruara më lart;

Lloji/emërtesa e Institucionit/subjektit ku është ushtruar veprimtaria :

Prokuroria e Përgjithshme

Adresa dhe kontaktet e Institucionit/subjektit :

Prokuroria e Përgjithshme, Rr. “Qemal Stafa”, nr. 1 Tiranë.

Ky Jetëshkrim i shërben për përdorim Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për procedurat e verifikimit dhe vlerësim, pikëzim, renditjes së kandidaturës.

Periudha : 15 Korrik 1995 deri 09 Maj 2008;

Lloji i detyrës/funksionit/veprimtarisë :

Prokuror / Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë

Përmbledhje e përgjegjësive të ushtruara :

Detyrat funksionale konsistojnë në thelb në ushtrimin e ndjekjes penale, përfaqësimin e akuzës në gjyq në emër të shtetit, marrjen e masave për ekzekutimin e vendimeve penale si dhe detyra të tjera të ngarkuara me ligj apo nga drejtuesi i prokurorisë.

Lloji/emërtesa e Institucionit/subjektit ku është ushtruar veprimtaria :

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë

Adresa dhe kontaktet e Institucionit/subjektit :

Rr. "Haxhi Hysen Dalliu", Tiranë.

Periudha : 29 Dhjetor 1993 deri 15 Korrik 1995;

Lloji i detyrës/funksionit/veprimtarisë :

Prokuror / Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Bulqizë.

Përmbledhje e përgjegjësive të ushtruara :

Detyrat funksionale konsistojnë në thelb në ushtrimin e ndjekjes penale, përfaqësimin e akuzës në gjyq në emër të shtetit, marrjen e masave për ekzekutimin e vendimeve penale si dhe detyra të tjera të ngarkuara me ligj apo nga drejtuesi i prokurorisë.

3. ARSIMIMI, KUALIFIKIMET, TRAINIMET DHE TITUJT PROFESIONALË

3.1 ARSIMIMI

(Renditen të gjitha, në zbritje kohore, duke filluar nga lloji më i fundit i arsimimit)

Periudha : 1989 - 1993

Diploma/Titulli i fituar : Jurist

Rezultati/Nota Mesatare :

Ky Jetëshkrim i shërben për përdorim Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për procedurat e verifikimit dhe vlerësim, pikëzim, renditjes së kandidaturës.

Emri dhe lloji i institucionit arsimor : Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë

Adresa dhe kontaktet e institucionit arsimor : Rr. "Mילו Tutulani", Tiranë.

3.2 KUALIFIKIMET PASUNIVERSITARE

(Renditen të gjitha, në zbritje kohore, duke filluar nga lloji më i fundit i arsimimit)

Periudha : _____

Diploma/Titulli i kualifikimit të fituar : _____

Rezultati/Nota Mesatare : _____

Emri dhe lloji i institucionit arsimor : _____

Adresa dhe kontaktet e institucionit arsimor : _____

3.3 TRAJNIMET

(Renditen të gjitha, në zbritje kohore, duke filluar nga lloji më i fundit i arsimimit)

Që nga momenti i fillimit të punës si prokuror në janar 1994 dhe deri 2008, kam marrë pjesë në disa prej trajnimeve vazhduese të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, por jo vetëm. Pas momentit që jam emëruar prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme (viti 2008), ligjërisht këto trajnime nuk kanë qenë të aplikueshme për këtë kategori prokurorësh, për shkak të eksperiencës disa vjeçare si prokuror.

Jashtë trajnimeve të shkollës së magjistraturës të cilat i kam frekuentuar rregullisht, kam marrë pjesë dhe në:

Periudha : 10 deri 11 tetor 2017

Tematika dhe fusha e trainimit të fituar: *“Asset tracing/identification for purposes of seizure and confiscation in a criminal case”.*

Emri dhe lloji i institucionit arsimor : Në kuadër të projektit *“Action Against Economic Crime in Albania” (AEC-AL)*, mbështetur nga Council of Europe, Office in Tirana.

Adresa dhe kontaktet e institucionit arsimor :

Ky Jetëshkrim i shërben për përdorim Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për procedurat e verifikimit dhe vlerësim, pikëzim, renditjes së kandidaturës.

Periudha : 1 deri 5 shtator 2008

Tematika dhe fusha e trainimit të fituar : “*Anti Money Laundering and Countering of Financing of Terrorism (AML/CFT) Measures*”.

Emri dhe lloji i institucionit arsimor : “Joint Vienna Institute”

Adresa dhe kontaktet e institucionit arsimor : Vienna, Austri

VEPRIMTARI TË TJERA PROFESIONALE

Në vitet 2008-2011, kam ushtruar funksionet e anëtarit dhe për një periudhë kohe dhe të Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Nga Shkurti i vitit 2010 e deri në Nëntor 2013, kam qenë si përfaqësues i Prokurorisë së Përgjithshme në Bordin Drejtues të Shkollës së Magjistraturës.

Nga muaji Korrik 2010 deri në Nëntor 2013, kam qenë anëtar i Këshillit Pedagogjik të të Shkollës së Magjistraturës. Me këtë cilësi, kam qenë i angazhuar me vlerësimet prezantimit të punëve të kryera prej magistratëve prokurorë pranë Shkollës së Magjistraturës Tiranë.

Po kështu, jam ngarkuar nga Prokurori i Përgjithshëm si drejtues në disa grupe pune të ngritura në Prokurorinë e Përgjithshme, dhe përfaqësues në takimet ndërinstitucionale gjatë viteve 2009-2012 si dhe në vitin 2018, lidhur me liberalizimin e vizave; në procesin e aplikimit të Shqipërisë si vend kandidat në Bashkimin Europian; lidhur me ndryshime ligjore në Kodin e Procedurës Penale, të ligjit për policinë gjyqësore, në mardhëniet e bashkëpunimit me Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM) në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve etj.

3.4 TITUJ PROFESIONALË

Periudha : _____

Lloji i titullit/ fusha profesionale : _____

Emri dhe lloji i institucionit që ka dhënë titullin : _____

Adresa dhe kontaktet e institucionit : _____

4. PUBLIKIME PROFESIONALE DHE KËRKIME SHKENCORE

Titulli i publikimit/ Kërkimit shkencor : _____

Autor/Bashkëautor/Kontribues : _____

Ky Jetëshkrim i shërben për përdorim Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për procedurat e verifikimit dhe vlerësim, pikëzim, renditjes së kandidaturës.

Subjekti/Institucioni botues/publikues : _____

Koha e botimit : _____

Faqja në web ku gjendet publikimi (nëse disponohet) : _____

5. ZOTËRIMI I GJUHËVE TË HUAJA

Gjuha	Të kuptuarit	Të folurit	Të shkruarit
Frengjisht	B2	B2	B2
Anglisht	B1	B1	B1
Italisht	B1	B1	A2

Shënim: Përcaktimi i niveli është bërë mbi bazën e një vetëvlerësimi, i cili i referohet Kuadrit të Përbashkët Evropian i Referencave për Gjuhët